

**Vendim nr. 337, datë, 24.12.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Illir Toska,	Anëtar

në datën 24.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 49 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** AULON KALAJA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 23, datë 17.07.2025 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për shqyrtim në themel pranë kësaj gjykate.

Konstatimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i neneve 124, pika 1 dhe 145, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në pjesën që nuk kanë parashikuar legjitimitetin aktiv për të ushtruar të drejtën e ankimit administrativ dhe të padisë/ankimit gjyqësor të kandidatëve të listave shumemërore preferenciale të partive politike ose koalicioneve.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 18, 42, 45, pika 1, 64, pika 3 dhe 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 3 i Protokollit nr. 1 të saj; neni 25 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e

**Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 03.03.2025, bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 2 të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (*Komisioneri*), Partia Demokratike dhe disa parti të tjera politike, ndër to, edhe Partia Lëvizja e Legalitetit, përmes një marrëveshjeje me shkrim, kanë rënë dakord për krijimin e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Shqipërinë Madhështore” (*koalicioni PD-ASHM*), i cili është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 11.05.2025 për Kuvendin e Shqipërisë (*Kuvendi*), me vendimin nr. 238, datë 04.03.2025 të KSHZ-së. Sipas marrëveshjes, kandidatët në listat shumemërore të koalicionit, pavarësisht se cilës parti i përkisnin, do të konsideroheshin dhe vlerësoheshin si kandidatë vetëm të koalicionit, duke shmangur trajtimin e tyre sipas përkatësive partiake. Në vijim, ky koalicion ka paraqitur për miratim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (*KQZ*) listat shumemërore për çdo zonë zgjedhore, të përbëra nga listat e kandidatëve me renditje të fiksuar dhe listat e kandidatëve që i nënshtroheshin votimit parapëlqyes. Në një nga këto të fundit, për zonën zgjedhore qarku Durrës, të miratuar me vendimin nr. 275, datë 17.03.2025 të Komisionerit, si kandidat i subjektit zgjedhor koalicioni PD-ASHM, është pasqyruar edhe emri i kërkuesit Aulon Kalaja, që vinte nga një prej partive politike në këtë koalicion, Partia Lëvizja e Legalitetit.

2. Pas përfundimit të procesit të votimit, për zgjedhjet e datës 11.05.2025, si dhe numërimit të votave, me vendimin nr. 1327, datë 24.05.2025 (*vendimi nr. 1327/2025*), Komisioneri ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultatit të votimit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore të qarkut Durrës. Kundër këtij vendimi, bazuar në nenin 124, pika 3, të Kodit Zgjedhor, subjekti zgjedhor koalicioni PD-ASHM ka paraqitur ankim administrativ përpara Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (*KAS*) të KQZ-së. Po ashtu, vendimi i Komisionerit është ankimuar edhe nga kërkuesi, në cilësinë e kandidatit për deputet. Ky

ankim, me vendim të ndërmjetëm nr. 88, datë 03.06.2025 të KAS-it, i është kthyer kërkuesit për plotësim, pasi nuk plotësonte elementet e kërkuara, ndër të tjera, edhe nga shkronja “a” e nenit 126 të Kodit Zgjedhor, për shkak se, referuar kërkesës dhe autorizimit bashkëlidhur saj, ishte e paqartë se cili ishte subjekti ankues, Partia Lëvizja e Legalitetit apo kandidati për deputet (kërkuesi). Në vijim, ankimi është paraqitur nga Partia Lëvizja e Legalitetit, përfaqësuar nga kërkuesi dhe KAS-i ka vendosur pranimin për shqyrtim të këtij ankimi duke e bashkuar me ankimin e paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni PD-ASHM.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve të koalicionit PD-ASHM dhe të Partisë Lëvizja e Legalitetit, me vendimin nr. 103, datë 07.07.2025, KAS-i ka vendosur rrëzimin e kërkesave ankimore në lidhje me kërkimin për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11.05.2025 në zonën zgjedhore të qarkut Durrës. Po ashtu, me këtë vendim, janë pranuar pjesërisht kërkesat ankimore për rivlerësimin dhe/ose rinumërimin e votave të kësaj zone zgjedhore, duke vendosur ndryshimin e vendimit të Komisionerit nr. 1327/2025 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit për zonën zgjedhore të qarkut Durrës, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e datës 11.05.2025, sipas tabelës së re përmbledhëse të rezultatit të votimit, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëngjitet vendimit. Kundër këtij vendimi, bazuar edhe në nenin 145 të Kodit Zgjedhor, kërkuesi dhe Partia Lëvizja e Legalitetit kanë ushtruar ankim gjyqësor.

4. Me vendimin nr. 23, datë 17.07.2025, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka vendosur pushimin e gjykimit, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv (formal) të paditësve (kërkuesit dhe Partisë Lëvizja e Legalitetit) për paraqitjen e kërkesëpadisë, në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, me arsyetimin se ata nuk janë subjekte zgjedhore sipas neneve 2, pika 20 dhe 63, pikat 1 dhe 2, të kodit. Sipas atij kolegji, kërkuesi ka qenë kandidat për deputet i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni PD-ASHM dhe jo nga një grup zgjedhësish, kurse Partia Lëvizja e Legalitetit është regjistruar në zgjedhje si pjesë e subjektit zgjedhor koalicioni PD-ASHM dhe nuk është regjistruar dhe as ka garuar në zgjedhje si subjekt zgjedhor më vete, duke paraqitur listë kandidatësh sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, sipas Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, të drejtat legjitime që rrjedhin nga pjesëmarrja në zgjedhje mbrohen nga subjekti zgjedhor të cilit paditësit i përkasin, pikërisht nga koalicioni PD-ASHM. Po ashtu, ai kolegji nuk ka pranuar pretendimin e paditësve për legjitimitetin e tyre në paraqitjen e kërkesëpadisë

bazuar në nenet 123 dhe 124 të Kodit Zgjedhor, duke arsyetuar se këto dispozita rregullonin të drejtën e ankimit administrativ, por jo të drejtën e ankimit gjyqësor.

5. Në datën 24.10.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga aktet e kundërshtuara i janë cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe ankimit efektiv, pasi Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, përmes vendimmarrjes jopërfundimtare për pushimin e gjykimit të çështjes, nuk i ka dhënë përgjigje në meritë pretendimeve të tij në padi lidhur me procesin e numërimit dhe të vlerësimit të votave, përfshirë ato preferenciale. Kjo e drejtë kërkuesit i është cenuar edhe nga KAS-i. Mënyra se si Kolegji Zgjedhor Gjyqësor dhe KAS-i kanë interpretuar dhe zbatuar nenet 124, pika 1 dhe 145, pika 1, të Kodit Zgjedhor i kanë cenuar atij edhe të drejtën për t'u zgjedhur, të garantuar nga neni 45, pika 1, i Kushtetutës, sepse parregullsitë në procesin e numërimit dhe vlerësimit të votave, përfshirë edhe ato preferenciale, ndikojnë drejtpërdrejt në renditjen e kandidatëve të subjektit zgjedhor, për pasojë edhe në fitimin e mandatit të deputetit. Ky interpretim dhe zbatim i dispozitave ligjore për legjitimitimin aktiv dhe mjetet e ankimit bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës, nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, për sa kohë i mohon kërkuesit mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës për t'u zgjedhur.

6.2. *E drejta për mjete juridike efektive*, e cila është cenuar jo vetëm si pasojë e procesit të parregullt ligjor të zhvilluar nga KAS-i dhe Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, por edhe për shkak të ometimit ligjor në nenet 124, pika 1 e 145, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në pjesën që nuk parashikojnë të drejtën e ankimit administrativ dhe/ose gjyqësor për kandidatët për deputet të përfshirë në listat shumëmemërore preferenciale të subjekteve zgjedhore, partive politike ose koalicioneve të tyre. Mosparashikimi i kësaj të drejte vjen në kundërshtim me nenet 4, 5, 17, 42, pika 2, 45, pika 1, 116 e 122 të

Kushtetutës, si dhe me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së. Në këtë kuptim, e drejta kushtetuese për t'u zgjedhur e kandidatit në listat shumemërore preferenciale të propozuar nga partia ose koalicioni i partive politike nuk mund të mbrohet vetëm nga këto subjekte zgjedhore, por edhe vetë kandidati duhet të ketë mjete mbrojtëse në përputhje me standardin e ankimit efektiv. Natyra diskrecionare e vendimmarrjes së partisë ose koalicionit të tyre për të ushtruar ose jo ankim administrativ ose gjyqësor e bën teorik dhe iluzor aksesin e kandidatit në gjykatë dhe bie ndesh edhe me standardet e Komisionit të Venecias, veçanërisht me rregullin 3.3 të Kodit të Sjelljes së Mirë të Çështjeve Zgjedhore, që kërkon ekzistencën e mjeteve efektive të ankimit në çështje zgjedhore. Në këtë mënyrë, partive politike ose koalicioneve të tyre u jepet mundësia të diktojnë në mënyrë ekskluzive në rezultatin e kandidatëve në listat shumemërore preferenciale, duke e bërë mbrojtjen e kandidatit të varur nga vullneti i subjektit politik. Po ashtu, ometimi ligjor i së drejtës së ankimit për kandidatët e listave shumemërore preferenciale të subjekteve zgjedhore parti politike ose koalicione të tyre bie ndesh edhe me *parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, për sa kohë, në mënyrë të pajustificuar, nuk i trajton ata në të njëjtën mënyrë me kandidatët e pavarur të propozuar nga zgjedhësit.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke parashtruar dy kërtime: *i) kërkitimi i parë* lidhet me kundërshtimin e vendimit të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor për pushimin e gjykimit të ankimit të tij ndaj vendimit të KAS-it, me

pretendimin se ka cenuar standardet e procesit të rregullt; ii) *kërkimi i dytë* lidhet me konstatimin e boshllëkut ligjor në nenet 124, pika 1, e 145, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në pjesën që nuk parashikojnë mjete ligjore efektive ankimi për kandidatët e listave shumemërore preferenciale të partive politike ose koalicioneve të tyre, me pretendimin se cenon të drejtat kushtetuese individuale të kësaj kategorie kandidatësh, përfshirë kërkuesin, si dhe parimet kushtetuese. Sipas nenit 48 të Ligjit Organik të Gjykatës, kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të dhe se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimet nr. 22, datë 23.04.2025; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 20, datë 04.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, duke qenë se thelbi i pretendimeve të kërkuesit lidhet me omentimin normativ të ligjit dhe efektet e tij në të drejtën për t'u zgjedhur sipas nenit 45 të Kushtetutës të lidhur edhe me parimin e barazisë sipas nenit 18 të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se legjitimiteti i tij duhet të shqyrtohet në funksion të këtij pretendimi.

9. Gjykata ka pohuar se, kur objekt i ankimit kushtetues individual është ligji ose akti normativ, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kritere: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 85, datë 24.12.2024; nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, në lidhje me kriterin e legjitimit *ratione personae*, Kolegji vëren se edhe pse kërkuesi është subjekt i së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur, ai duhet

të provojë se ometimi/boshllëku ligjor në lidhje me mosparashikimin e mjetit të ankimit e privon atë drejtpërdrejt dhe realisht nga e drejta për të pasur mjete juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur, pra se është viktimë e drejtpërdrejtë e shkeljes së pretenduar. Për këtë qëllim, kërkohet të provohet se, për shkak të rregullimit ligjor të kundërshtuar, kërkuesi mbetet praktikisht pa një mjet efektiv mbrojtjeje ose se mjete ekzistues është teorik dhe iluzor në rrethanat konkrete.

11. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, konstaton se kërkuesi ka qenë pjesë e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputetë që i nënshtroheshin votimit parapëlqyes, të subjektit zgjedhor koalicioni PD-ASHM, për zonën zgjedhore të qarkut Durrës, listë kjo e miratuar me vendim të KQZ-së. Në përfundim të procesit zgjedhor kërkuesi ka kundërshtuar në KAS, fillimisht si individ (kandidat për deputet), vendimin e Komisionerit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore të qarkut Durrës dhe pas kthimit të kërkesës ankimore për plotësim në drejtim të identifikimit të qartë të subjektit ankues, ajo është paraqitur në vijim në emër të Partisë Lëvizja e Legalitetit, përfaqësuar nga kërkuesi. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit administrativ, KAS-i ka vendosur rrëzimin e tij në lidhje me shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore të qarkut Durrës, duke e vlerësuar ankimin si të pambështetur në ligj dhe në prova, ndërkohë që e ka pranuar pjesërisht atë në lidhje me rivlerësimin dhe/ose rinumërimin e votave të kësaj zone zgjedhore, duke ndryshuar vendimin e Komisionerit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për këtë zonë zgjedhore, sipas tabelës së re përmbledhëse të rezultatit të votimit, sipas lidhjes bashkëlidhur vendimit. Ky vendim është ankimuar në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nga kërkuesi dhe nga Partia Lëvizja e Legalitetit dhe ai kolegji ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, duke vlerësuar se asnjë nga ankuesit (paditësit) nuk gëzonte legjitimitet aktiv në ngritjen e ankimit (kërkesëpadisë), për shkak se duke mos qenë subjekte zgjedhore në kuptim të Kodit Zgjedhor, nuk gëzonin të drejtën për paraqitjen e ankimit gjyqësor.

12. Sipas nenit 64, pika 3, të Kushtetutës: *“Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumëmemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet [...]”*, ndërsa sipas nenit 68, pika 1, të Kushtetutës: *“Kandidatët për deputetë*

*paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit [...]”*. Edhe pse pas këtyre ndryshimeve kushtetuese të vitit 2020 Kuvendi ka miratuar ndryshimet përkatëse në Kodin Zgjedhor (me ligjet nr. 118/2020, datë 05.10.2020, nr. 81/2024, datë 26.07.2024 dhe 10/2025, datë 17.02.2025), ato nuk kanë prekur dhe nuk kanë sjellë ndryshime në përmbajtjen e neneve 124, pika 1 e 145, pika 1, të kodit në drejtim të së drejtës për të paraqitur ankim administrativ dhe ankim gjyqësor, e drejtë kjo e fundit që u njihet vetëm subjekteve zgjedhore.

13. Referuar delegimit kushtetues për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për zbatimin e sistemit zgjedhor, Kodi Zgjedhor ka përkufizuar si subjekte zgjedhore, sipas nenit 2, pika 20, të tij, partitë politike, koalicionet e tyre dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, të regjistruar në përputhje me këtë kod. Sipas nenit 63 të po këtij kodi, subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë kod, si edhe një individ i propozuar nga zgjedhësit si kandidat për deputet. Si të tilla, subjektet zgjedhore kanë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, përveç detyrimeve, edhe një sërë të drejtash, gjatë dhe në përfundim të procesit zgjedhor, ku përfshihet edhe e drejta e ankimit ndaj vendimeve që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, përfshirë edhe ato për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit të zonës zgjedhore përkatëse.

14. Kontributi i së drejtës së votës, si një nga të drejtat themelore politike që gëzon individi, është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa dallime mbi bazë shtrese ose përkatësie në grupe të caktuara shoqërore, ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike (*shih vendimet nr. 28, datë 13.07.2021; nr. 40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së votës, që përfshin komponentin e tij aktiv (e drejta për të votuar) dhe atë pasiv (e drejta për t’u votuar/zgjedhur), ndalon diskriminimin ose privilegjimin nga shteti të kandidatëve të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në garën për të tërhequr votën e zgjedhësit (*shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr. 28, datë 09.05.2012; nr. 32, datë 21.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka theksuar se partitë politike, në kuptimin kushtetues dhe ligjor, paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit (*shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr.1, datë 07.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Ato luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin demokratik pluralist, pasi kontribuojnë në shfaqjen e vullnetit politik të popullit përmes

pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ndihmojnë në realizimin e sovranitetit të tij. Falë këtyre funksioneve ato kanë status kushtetues dhe konsiderohen elemente të domosdoshme të jetës politike (*shih vendimin nr. 28, datë 09.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Referuar nenit 68 të Kushtetutës, në thelb, subjekti që konkurren në zgjedhjet parlamentare është partia politike, e cila përcakton në listën shumëmemërore kandidatët e saj, përfshirë edhe ata që do t'i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Mbi këto premisa, është vlerësuar se nuk ka cenim të parimit të barazisë përpara ligjit ndërmjet kandidatëve, për sa kohë që kandidatët në listën shumëmemërore janë kandidatë të partisë politike, ndërsa është kjo e fundit ajo që konkurren si subjekt zgjedhor (*shih vendimin nr. 85, datë 24.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po ashtu, Gjykata është shprehur se, sipas Kodit Zgjedhor, partitë politike, në dallim nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, kanë të drejtë të marrin pjesë në koalicione zgjedhore, për të realizuar disa synime, ndër të cilat, më kryesori lidhet me maksimalizimin e numrit të votave, që më pas përkthehen në mandate sipas rregullave përkatëse. Edhe pse kandidatët që mbështeten nga partitë politike (pra janë të përfshirë në listat e tyre), ashtu si ata që propozohen e mbështeten nga zgjedhësit, mund të kandidojnë vetëm në një zonë zgjedhore, në ndryshim nga këta të fundit, kandidati i partisë politike ose koalicionit zgjedhor, i cili në fakt nuk përmendet si subjekt zgjedhor, merr pjesë në ndarjen e mandateve për kandidatët e listës sipas formulës së parashikuar nga ligji zgjedhor, çka do të thotë se mënyra e llogaritjes së vlerës së votës për këto dy kategori është e ndryshme. Gjykata, duke vlerësuar se “kandidati i propozuar nga zgjedhësit” nuk ndodhet në situatë të njëjtë me subjektet zgjedhore “parti politike” dhe “koalicion partish politike”, ka arritur në përfundimin se parashikimi i rregullave të njëjta lidhur me kufizimin e shpërndarjes së mandateve përbën diskriminim të tërthortë të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit në të drejtën për t'u zgjedhur dhe për shanse të barabarta në procesin zgjedhor (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Ndërkohë, sipas GJEDNJ-së, nocioni i “të drejtave individuale” (*shih Aziz k. Qipros, nr. 69949/01, datë 22.06.2004, § 25 dhe Ždanoka k. Letonisë [Dh.M.], nr. 58278/00, datë 16.03.2006, § 102*) ose “të drejtave subjektive” (*shih Melnychenko k. Ukrainës, nr. 17707/02, datë 19.10.2004, § 54*) për të kandiduar në zgjedhje sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, kryesisht është kufizuar në personat fizikë. Megjithatë, është pranuar edhe se kur legjislacioni zgjedhor ose masat e marra nga autoritetet kombëtare kufizojnë të drejtën e kandidatëve individualë për të kandiduar në zgjedhje përmes një liste partiake, partia përkatëse, si një entitet,

mund të pretendojë të jetë viktimë sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1, pavarësisht nga kandidatët e saj (*shih Partia Konservatore Ruse e Sipërmarrësve etj. k. Rusisë, nr. 55066/00 dhe 55638/00, datë 11.01.2007, §§ 53-67*).

18. Thënë sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuesi ka marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin jo si kandidat i pavarur (kandidat i propozuar nga zgjedhësit), por si kandidat i një koalicioni partish politike, i përfshirë në listën që i nënshtrohet votimit parapëlqyes, duke pranuar vetë që të kandidojë nën logon e këtij koalicioni, i cili, sipas Kodit Zgjedhor, në momentin e regjistrimit ka marrë cilësinë e subjektit zgjedhor. Kolegji konstaton se, në kuptim të rregullimeve të Kodit Zgjedhor, e drejta për ankim kundër akteve të administrimit zgjedhor, përfshirë edhe ankimin gjyqësor, sikundër çdo e drejtë tjetër gjatë procesit zgjedhor, edhe pse u njihet vetëm subjekteve zgjedhore, ushtrohet për mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme në procesin zgjedhor, ku përfshihen edhe interesat dhe të drejtat e çdo kandidati të veçantë të atij subjekti (parti apo koalicion). Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë se ky rregullim e ka bërë të pamundur, teorik ose iluzor ushtrimin e së drejtës së ankimit në funksion të mbrojtjes të së drejtës për t'u zgjedhur. Përkundrazi, nga vetë zhvillimet procedurale rezulton se ankimi administrativ është ushtruar nga subjekti zgjedhor koalicioni PD-ASHM, si dhe nga Partia Lëvizja e Legalitetit, e përfaqësuar nga kërkuesi, ankime që kanë pasur të njëjtin objekt dhe kanë synuar të njëjtin rezultat të lidhur me procesin. Për sa i përket ankimit gjyqësor, Kolegji nuk mund të arsyetojë në mënyrë abstrakte për rastin konkret në lidhje me faktin e paraqitjes së ankimit në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor vetëm nga Partia Lëvizja e Legalitetit dhe kërkuesi, por jo nga subjekti zgjedhor PD-ASHM. Kolegji arrin në këtë përfundim për sa kohë që, në këndvështrimin kushtetues, nuk është arritur të provohet se mjeti ligjor i parashikuar nga legjislacioni zgjedhor (e drejta e ankimit nga subjekti zgjedhor) nuk siguron mbrojtje efektive të të drejtave të kandidatëve të partive politike, përfshirë të drejtën për t'u zgjedhur, dhe se ky mjet përbën një pengesë reale dhe të pakapërcyeshme për vetë kandidatin, duke e bërë atë thjesht teorik ose iluzor.

19. Kolegji vlerëson se kërkuesi, ashtu edhe kandidatët e listës shumemërore preferenciale të partisë politike ose koalicioneve të tyre nuk mund të trajtohen në të njëjtën mënyrë me kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, të cilët i gëzojnë të drejtat sipas Kodit Zgjedhor, përfshirë edhe atë të ankimit, në të njëjtën mënyrë si partitë politike ose koalicionet e tyre, pikërisht për shkak të cilësisë së tyre si subjekte zgjedhore. Edhe pse e drejta e ankimit i njihet dhe ushtrohet formalisht nga subjekti zgjedhor parti politike ose koalicioni i tyre, kjo nuk përket në një të drejtë individuale

të çdo kandidati të listës shumemërore, por në një mjet procedural në dispozicion të subjektit zgjedhor për mbrojtjen e interesave të tij të ligjshëm në procesin zgjedhor. Kolegji vlerëson të theksojë se mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet kandidatëve të një liste shumemërore që i nënshtrohet votimit parapëlqyes dhe vetë subjektit zgjedhor, parti ose koalicion, ku ata kanë zgjedhur me vullnet të lirë të bëjnë pjesë, i përkasin sferës së marrëdhënieve të brendshme të këtij subjekti dhe nuk mund të zgjidhen nëpërmjet ankimit kushtetues individual ose të përbëjnë lëndë për gjykimin kushtetues. Si të tilla, ato nuk mund të shërbejnë si premisë të legjitimitetit të një ankimi kushtetues, edhe kur lidhen me mënyrën e ushtrimit të mjeteve procedurale gjatë procesit zgjedhor.

20. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk plotëson kriterin e legjitimitetit *ratione personae* për vënien në lëvizje të kontrollit kushtetues të normës ligjore të pretenduar se përmban ometim/boshllëk ligjor, pasi nuk provon se mosparashikimi i mjetit të ankimit (administrativ dhe/ose gjyqësor) për kandidatët e listave shumemërore preferenciale të partive politike ose koalicioneve të tyre, e ka privuar atë, në mënyrë personale, të drejtpërdrejtë dhe reale, nga një mjet efektiv mbrojtjeje të së drejtës për t'u zgjedhur sipas nenit 45 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të këtij kontrolli kushtetues.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.